



**Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo**



**Kuvendi i Komunës Kaçanik
Skupština Opština
Municipal Assambly**

KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK

SHËRBIMI PËR PUNË PROFESIONALE TË KUVENDIT

BULETINI PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS 15.11.2009 - 31.12.2010

Kaçanik, 2010

H Y R J E

Ky Buletin përfshinë Aktivitetin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, prej zgjedhjeve të datës : 15.11.2009-31.12.2010.

Bazë për përpilimin e këtij Buletini kanë shërbyer Procesverbalet e përpiluara gjatë punës së Kuvendit. Buletini është përpiluar nga Shërbimi për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës.

Qëllimi i këtij Buletini është pasqyrimi i aktivitetit të kuvendit të komunës për gjatë kësaj periudhës njëvjeçare, sistemimi i tyre dhe njoftimi i strukturave komunale në drejtim që të jetë sa më transparent aktiviteti i zhvilluar.

Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit është mirënjohës për vërejtjet dhe sugjerimet që do të epen lidhur në te. Këto vërejtje dhe sugjerime do të ndihmojnë që aktiviteti në punën e ardhshme të jetë sa më i suksesshëm dhe cilësor.

ECURIA E ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës u mbajtën më 15 Nëntor 2009.

Në këto zgjedhje është votuar për: Kuvendet Komunale dhe për Kryetar të Komunave.

Në komunën e Kaçanikut në këto zgjedhje, konkurruan 5 parti politike dhe një kandidat i pavarur.

Numri i votuesve të regjistruar është : 29.397, nga ky numër në zgjedhje kanë dal : 50.4% e popullatës më të drejtë vote.

Konkurruesit në garat zgjedhore, për kuvendin e komunës , arritën këto rezultate;

1. Për PDK-Partia Demokratike e Kosovës, 13 vende,	votuan	6,374	apo	47,57%	dhe fitoi
2. Për AAK- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, 07 vende	“	3,411	apo	25,46%	“
3. Për LDK-Lidhja Demokratike të Kosovës, 04 vende	“	2,205	apo	16,46%	“
4. Për AKR- Aleanca Kosova e Re , 02 vende	“	1,068	apo	7,97 %	“
5. Për LDD –Lidhja Demokratike e Dardanisë , 01 vend,	”	333	apo	2,49%	“
6. Për Kandidati e pavarur –Naim Mustafa, 0 vend	“	09	apo	0,07%	“

Për kryetar të komunës së Kaçanikut, konkurruan;

1. Nga PDK-a , Xhabir Zharku, dhe mori numrin e votave:	48.3%,
2. Nga LDK-a, Lulzim Dema	“ 15.9 %,
3. Nga AAK-a, Tahir Çaka	“ 26.7 % ,

4. Nga AKR-a, Afrim Loku	“	9.0% ,
5. Nga LDD-a, Shiqeri Luzha	“	6.3% dhe
6. Kandidati i Pavarur , Naim Mustafa ,	“	0.1%.

Meqenëse asnjë nga kandidatët që konkurruan për kryetar komune nuk kanë fituar shumicën e votave, atëherë dy kandidatët me numër më të madh të votave;

1. Xhabir Zharku nga PDK-a dhe

2. Tahir Çaka nga AAK-a

kanë shkuar në Balotazh- në Rundin e dytë të votimit.

Rundi i dytë i zgjedhjeve (balotazhi) për kryetar të komunave, është mbajtur më datë 13 dhjetor 2009. Në votime kanë dal: 45.6% e popullatës më të drejtë vote.

Për Kandidatin nga PDK-a , Xhabir Zharku kanë votuar: 7.548 veta apo 57.9%, ndërsa për Kandidatin nga AAK-a ,Tahir Çaka kanë votuar: 5.483 veta apo 42.1%.

Për kryetar komune më numër më të madh të votave u zgjodh, XHABIR ZHARKU nga subjekti i PDK-së.

PËRBËRJA E KUVENDIT TË KOMUNËS

Sipas Ligjit Nr. 03/L-040-Për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare nr. 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 35 Kuvendi i Komunës është organi më i lartë legjislativ i komunës, ndërsa organi më i lartë ekzekutiv sipas nenit 56 po të këtij ligji është: Kryetari i Komunës, organe këto të zgjedhura në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët, në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale, për mandat 4 vjeçar.

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut i dal më zgjedhjet e mbajtura më 15.11.2009, numëron 27 anëtarë.

Përbërja e kuvendit të komunës pasqyron përfshirjen e spektrit politik që kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe kanë fituar numër të mjaftueshëm të votave.

Kuvendi i Komunës Kaçanik ka këtë përbërje të spektrit politik;

Nga Dega e PDK-së (Partia Demokratike e Kosovës):

- | | |
|--------------------|---|
| 1. Xhelal Gashi, | 8. Krenare Luzha, |
| 2. Ilaz Ceka, | 9. Zekirja Loku (shef i grupit parlamentarë), |
| 3. Tefik Vishi, | 10. Habib Guri, |
| 4. Hestet Loku, | 11. Florija Dallosi, |
| 5. Afrim Bunjaku, | 12. Arbnora Sallahu dhe |
| 6. Kemajl Murseli, | 13. Diana Bajrami. |

7. Driton Thaqi,

Nga Dega e AAK-së (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):

- | | |
|--|----------------------|
| 1. Shiqeri Luzha, | 5. Sevdije Frangu, |
| 2. Shukri Luta (shëf i grupit parlamentarë), | 6. Nerimane Lika dhe |
| 3. Hajdar Loku, | 7. Afërdita Deda. |
| 4. Rami Çaka, | |

Nga Dega e LDK-së (Lidhja Demokratike e Kosovës):

1. Daut Rudi (shëf i grupit parlamentarë),
2. Ibrahim Hoxha,
3. Nazife Krasniqi dhe
4. Florijeta Gashi .

Nga Dega e AKR-së (Aleanca Kosova e Re):

1. Ali Krasniqi (shëf i grupit parlamentarë)
2. Sherife Troni.

Nga Dega e LDD-së (Lidhja Demokratike e Dardanisë):

1. Elife Murseli (shëfe e grupit parlamentarë).

Përbërja e këtillë e kuvendit të komunës pëson ndryshime, më atë që në vend të Heset Lokut, për shkak të dorëheqjes së tij si pasojë e mospërputhshmërisë së funksionit, caktohet :
Ramadush Osmani.

Më Vendim të kryetarit të komunës në postin e Nënkyetarit të Komunës është emëruar, Heset Loku, më profesion: Jurist i diplomuar.

Më vendim të kryetarit të komunës janë emëruar drejtorët e drejtorive komunale, dhe atë;

Jeton Topalli, për drejtor në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme(DAP),
Misim Sopa, DSHMS, për drejtor në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,

Nuhi Provoliu, për drejtor në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, (DBPZHR),

Rushan Ceka, për drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës(DSHPE)

Bekim Troni, për drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit,

Fikri Verbani, për drejtor në Drejtorinë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim (DEFZH) dhe

Azem Guri, për Drejtor në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës(DA

Aktiviteti i Kuvendit të Komunës,

Viti 2009

Inaugurimi (Konstituivi) i Kuvendit të Komunës

Mbledhja Inauguruese (Konstituive) e Kuvendit të Komunës Kaçanik, është mbajtur më datë: 30.12.2009 në katin e III-të të objektit e administratës komunale në sallën e kuvendit. Mbledhjen e ka ftuar kryetari i deritanishëm i komunës z. Xhabir Zharku.

Në këtë mbledhje në rend pune ishin këto pikë:

1. Fjala mirëseardhëse e kryetarit të komunës,
2. Fjala mirëseardhëse e këshilltarit më të vjetër të kuvendit të komunës,
3. Dhënia e Betimit të këshilltarëve të kuvendit të komunës,
4. Dhënia e Betimit të kryetarit të komunës,
5. Fjala përshëndetëse e kryetarit të komunës,
6. Zgjedhja e kryesuesit të kuvendit të komunës,
7. Fjala përshëndetëse e kryesuesit të kuvendit,
8. Deklarata e gjendjes së pasurisë e këshilltarëve të kuvendit komunal dhe e kryetarit të komunës dhe
9. Mbyllja e seancës.

1. Mbledhjen e hapi kryetari i gjertanishëm i komunës z. Xhabir Zharku, i cili pasi përshëndeti këshilltarët e zgjedhur të kuvendit, fjalën ia dha këshilltarit më të vjetër të kuvendit të komunës z. Rami Çaka, për të udhëhequr më mbledhjen.

2. Këshilltari më i vjetër i zgjedhur i kuvendit të komunës, z. Rami Çaka, pasi përshëndeti të pranishmit e kësaj mbledhje, vazhdoi të udhëheqë më mbledhjen deri më zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit.

3. Në këtë mbledhjen e dhanë betimin 27 anëtarë të zgjedhur të Kuvendit të Komunës dhe të njëjtit e nënshkruan deklaratën solemne. Më këtë rast konstatohet se u; Konstitua (Inaugurua) kuvendi i komunës në Kaçanik.

4. Më dhënien e Betimit dhe nënshkrimin të deklaratës solemne të kryetarit të zgjedhur të komunës z. Xhabir Zharku, konstatohet se u; Konstitua (Inaugurua) kryetari i komunës së Kaçanikut.

5. Kryetari i zgjedhur i komunës z. Xhabir Zharku i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje dhe e falënderoj qytetarët e komunës së Kaçanikut për besimin e dhënë për të udhëhequr më komunën e Kaçanikut.

6. Për kryesues të kuvendit të komunës, më votim të fshehtë në rundin e parë të votimit u zgjodh më shumicë votash-14 votë PËR, Xhelal Gashi, më profesion : Jurist i diplomuar.

7. Kryesuesi i zgjedhur i kuvendit të komunës z. Xhelal Gashi, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje dhe i falënderoj për besimin e dhënë për të udhëhequr më kuvendin e komunës.

8. Në këtë mbledhje Këshilltarët e zgjedhur të kuvendit të komunës e deklaruan gjendjen e pasurisë.
9. Seancën e konstatoj të mbyllur , kryesuesi i kuvendit z. Xhelal Gashi.

V i t i 2010

Mbledhja e I-rë(Parë)

Mbledhja e I-rë (Parë) e rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur më datë: 27.01.2010, kryesuar dhe udhëhequr nga, Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1. Merr Vendim për Aprovimin e Planit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2010,
2. Merr Vendim për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa,
3. Merr Vendim për formimin e Komiteti për Komunitete dhe
4. Aprovon Programet e Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2010.

K o m i t e t i p ë r P o l i t i k ë d h e F i n a n c a :

Formohet Komiteti për Politikë dhe Financa, në këtë përbërje:

1. Xhelal Gashi, për kryesues (sipas funksionit që ka) nga PDK,
2. Zekirja Loku, për anëtar nga PDK,
3. Arbnora Sallahu, “ PDK,
4. Kemajl Murseli, “ PDK
5. Shukri Luta, “ AAK,
6. Shiqeri Luzha, “ AAK dhe
7. Daut Rudi, “ LDK.

K o m i t e t i p ë r K o m u n i t e t e :

Formohet Komiteti për Komunitete , në këtë përbërje:

- Rami Çaka, për anëtar nga AAK
Ibrahim Hoxha, “ LDK,

Sherife Troni, “ AKR,
Bislim Krasniqi, “ shoqëria civile dhe
Bahrije Çaka, “ shoqëria civile.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete zgjidhet nga radhët e veta.

Mbledhja e II-të (Dytë),

Mbledhja e II-të (Dytë) e rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur më datë: 26.02.2010, Mbledhjen e kryeson dhe më të udhëheq, kryesuesi i kuvendit, z.Xhelal Gashi.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës Aprovon këto çështje:

1. E Jep Betimin Solemn dhe e Nënshkroi Deklaratën Solemne Këshilltari i zgjedhur, z. Ramadush Osmani.
2. Merr Vendim për formimin e Komiteteve Konsultative të Kuvendit,
3. Merr Vendimi për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga të hyrat vetjake komunale te viteve ;2008 dhe 2009 në vitin vijues buxhetor 2010,
4. Njoftohet më Buxhetin e komunës së Kaçanikut për vitin 2010 dhe vlerësimet për vitin 2011-2012, dhe
5. Njoftohet më Raportin për Realizimin e mjeteve buxhetore për periudhën: janar-dhjetor 2009.

2. K o m i t e t e t K o n s u l t a t i v e t e K u v e n d i t

Formohen këto Komitetet Konsultative të Kuvendit:

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
2. Komiteti për Arsim dhe Kulturë,
3. Komiteti për Zhvillim Ekonomik,
4. Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit,
5. Komiteti për Emergjencë dhe Shërbime Publike dhe
6. Komiteti për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.

Komitetet Konsultative nga 1-6 , kanë përbërje 5 anëtarë, ndërsa Kriteret për anëtarësim, Rregullohen më Konkurs.

Mbledhja e III-të (Tretë),

Mbledhja e III-të ,(Tretë) e rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur më datë: 30.03.2010. Mbledhjen e kryeson dhe më te udhëheq z. Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit .

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës, e;

1. Aprovon Raportin e Punës së Ekzekutivit të komunës për vitin 2009,
2. Aprovon Raportin Vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009 dhe
3. Merr Vendim për ndarje trualli për ngritjen e bustit të heroit kombëtar , Idriz Seferi.

Mbledhja e IV-të (Katërt),

Mbledhja e IV-të (Katërt) e rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur më datë: 29.04.2010. Mbledhjen e kryeson dhe më te udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit, z.Xhelal Gashi.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës,e;

1. Aprovon Raportin e Realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën: janar-mars, 2010,
2. Njoftohet më Organogramin e Komunës së Kaçanikut,
3. Merr Vendim për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve për KRM”Pastërtia” Sh.A-Njësia në Kaçanik, në përbërje;
Heset Loku (emëruar nga kryetari i komunës),
Driton Thaqi dhe
Elife Murseli.
4. Merr Vendim për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve për NKP “Lypeteni” në përbërje;
 1. Rushan Ceka (emëruar nga kryetari i komunës)
 2. Diana Bajrami dhe
 3. Ramadan Osmani.

Mbledhja e V-të (Pestë),

Mbledhja e V-të(Pestë) e rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur më datë: 08.06.2010. Mbledhjen e kryeson dhe më të udhëheq Kryesuesi i Kuvendit, z.Xhelal Gashi.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

2. Merr Vendim për Aprovimin e Planit Zhvillimor Urban i Komunës së Kaçanikut,
3. Merr Vendim për Aprovimin në Parim të Rregullores për pagesën e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve të tjera komunale,dhe e njëjta lëshohet në procedurë të debatit publik më qytetarë.
4. Merr Vendim për Aprovimin e Rregullores për Leje Pune të Shoqërive Tregtare,
5. Merr Vendim për Aprovimin e Rregullores për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Kaçanikut dhe
6. Merr Vendim për Aprovimin e Rishikimit të Buxhetit të komunës për vitin 2010.

Mbledhja e VI-të (Gjashtë),

Mbledhja e VI-të(Gjashtë) e rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur më datë: 30.06.2010, Mbledhjen e kryeson dhe më te udhëheq Kryesuesi i Kuvendit ,Xhelal Gashi.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës, e;

1. Aprovon Kornizën Afatmesme Buxhetore e komunës së Kaçanikut për vitet: 2011-2013,
2. Merr Vendim për Aprovimin e Rregullores për caktimin e orarit të punës së subjekteve afariste në territorin e komunës së Kaçanikut dhe
3. Merr Vendim për Aprovimin e Rregullores për përdorimin e gjuhëve në institucionet e komunës së Kaçanikut.

Mbledhja e VII-të (Shtatë),

Mbledhja e VII-të(Shtatë) e rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur më datë: 27.07.2010. Mbledhjen e kryeson dhe më të udhëheq ,Kryesuesi i Kuvendit z. Xhelal Gashi.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1. Merr Vendim për Aprovimin e Rregullores për pagesën e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve tjera komunale,
2. Aprovon Raportin për Realizimin e mjeteve buxhetore për periudhën: janar-qershor, 2010 dhe
3. Aprovon Propozim- Vendimi për lirim nga pagesa e taksës për marrjen e Lejes së ndërtimit , Këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik, për Ndërtimin e objektit fetar- XHAMI, në Kovaqec.

Mbledhja e VIII-të (Tetë),

Mbledhja e VIII-të(Tetë) e rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur më datë: 24.09.2010. Mbledhjen e kryeson dhe më te udhëheq Kryesuesi i Kuvendit z.Xhelal Gashi.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1. Merr Vendim për Aprovimin e Rregullores për vendosjen e tatimit në pronë në territorin e komunës së Kaçanikut për vitin 2011,
2. Aprovon Propozim-Vendimin për rregullimin e ndarjeve buxhetore në buxhetin e komunës së Kaçanikut për vitin 2010,
3. Aprovon Draft- Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin 2011 dhe vlerësimet për vitin 2012-2013,
4. Aprovon Propozim-Vendimi për mënyrën e llogaritjes dhe lartësinë e kompensimit për pranimin teknik të objekteve dhe
5. Merr Vendim për caktimin e taksave për shitjen e mbeturinave drusore.
6. Prolongon Propozim-vendimi për mënyrën e llogaritjes dhe lartësinë e kompensimit për pranimin teknik të objekteve.

Mbledhja e IX-të (Nëntë),

Mbledhja e IX-të(Nëntë) e rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur më datë: 29.10.2010. Mbledhjen e kryeson dhe më te udhëheq Kryesuesi i Kuvendit z.Xhelal Gashi.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1. Merr Vendim për Aprovimin e Rregullores për ndalimin e zënies së palejuar të hapësirave publike dhe ekspozimit të mallrave jashtë lokaleve afariste,
2. Merr Vendim për Aprovimin e Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01Nr.05-5318/10- Për caktimin e orarit të punës së subjekteve afariste në territorin e komunës së Kaçanikut,
3. Debaton lidhur më Raportin për realizimin e mjeteve buxhetore, për periudhën: janar-shtator, 2010 dhe Raporti i ekzekutivit për periudhën: janar-shtator, 2010,
5. Aprovon Propozim-Vendimin për mënyrën e llogaritjes dhe lartësinë e kompensimit për pranimin teknik të objekteve dhe
6. Njoftohet më Raportin e Auditorit të Pavarur , për vitin 2009.

Mbledhja e X-të (Dhjetë),

Mbledhja e X-të(Dhjetë) e rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur më datë: 28.12.2010. Mbledhjen e kryeson dhe më te udhëheq Kryesuesi i Kuvendit z.Xhelal Gashi.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1. Merr Vendim për miratimin e planit zhvillimor të komunës së Kaçanikut,
2. Aprovon Statutin e Qendrës kryesore të mjekësisë familjare të komunës së Kaçanikut,
3. Merr Vendim për ndryshim plotësimin e Rregullores për tarifat dhe ngarkesat administrative dhe shërbimet tjera komunale(shtohen tarifa dhe ngarkesa në DBPZH) dhe
4. Aprovon Vendimin për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e shujtës së ushqimit për 2 muaj për shërbyesit civil.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, gjatë vitit 2010, mban dy mbledhje më karakter solemn dhe atë; më datë: 17.02.2010, Kuvendi i Komunës ia kushton një mbledhje solemne 17 shkurtit-Ditës së Pavarësisë së Kosovës dhe më datë: 11.06.2010, Kuvendi i Komunës ia kushton një mbledhje solemne 11 Qershorit-Ditës së Çlirimit të Komunës.

Monitorimi i mbledhjeve të Rregullta të Kuvendit të Komunës është bërë nga OSBE-a, KFOR-i dhe MAPL-a. Në mbledhjen e IX-të të Rregullt të Kuvendit ka marrë pjesë edhe drejtor i qendrës regjionale të OSBE-së më seli në Gjilan, z. Ulrich Biffar, i cili e dekoroj kuvendin e komunës më “Mirënjohje” për aktivitetin e zhvilluar.

Zgjedhjet Parlamentare në Republikën e Kosovës janë mbajtur me datë: 12.12.2010. Në këto zgjedhje është votuar për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Fushata zgjedhore ka filluar më datë: 01.12.2010.

Përgatiti: Shërbimi i Kuvendit,